

AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 20.3.2019

**PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË
SUDANIN E JUGUT (UNMISS)**

(ndryshuar me aktin normativ nr. 3, datë 21.6.2023)

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pjesëmarrjen 3 (tre) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), në Republikën e Sudanit të Jugut.

Neni 2

Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është mbështetja dhe dhënia e kontributit në Shtabin Rajonal të Forcës Mbrojtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Juba, si dhe në Shtabin e Komandës Bor, Jonglei, në Sudanin e Jugut.

Neni 3

Ushtarakët, të cilët do të marrin pjesë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), për ditët e qëndrimit në këtë mision do të marrin, veç pagës mujore, edhe dietë ditore për vështirësi shërbimi, në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe